

Nr. 8 Regj.

Durrës, më 20. 09. 2024

Lënda: Në përgjigje të kërkesës suaj.**Emër MBIEMËR**

Në kuadër të implementimit të Ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit” (i ndryshime), si dhe në referencë të kërkesës suaj, datë 10.09.2024 me objekt “*Studimi Socio-ekonomik dhe Inventarin e aseteve per parcelat e ndikuara nga projekti - Rehabilitimi i hekurudhes Vore - Hani Hotit*”, e regjistruar në regjistrin e “Kërkesë/Ankesë/Përgjigje” në përputhje me nenin 8 të ligjit të sipërcituar me Nr. 8, ju informojmë për si vijon:

Në kuadër të Projektit “*Rehabilitimi i linjës hekurudhore Vora-Hani i Hotit*”, “Hekurudha Shqiptare” sha është duke implementuar procesin për inventarizimin (Census) dhe vlerësimin e pasurive/aseteve të prekura nga ky projekt. Ky proces ka filluar në gusht 2024 dhe do të përfundojë në tetor 2024, me realizimin e tij nga kompania Abkons.

Qëllimi i posterave dhe fletushkave të shpërndara përgjatë linjës hekurudhore Vora-Hani i Hotit, si dhe në bashkitë përkatëse, ishte njoftimi i komuniteteve për fillimin e procedurës së studimit për shpronësim, dhe jo thirrje për pjesëmarrje në procesin e Censurit. Kjo procedurë është e përkohshme (afat-shkurter) dhe kërkon njohuri dhe trajnim sipas standardeve të BERZH.

Per sa më sipër, kërkesa juaj për përfshirje në procesin e censurit nuk mund të merret parasysh në këtë moment procedural.

**Autoriteti publik “Hekurudha Shqiptare” Sh.A, angazhohet në garantimin e të drejtës së informimit, si garanci kushetuese dhe vepron në mbështetje të ligjit Ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të Drejtën e informimit” dhe trajton kërkesën tuaj në përputhje me Ligjin nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.*

Me konsideratë!

KOORDINATORI I TË DREJTËS SË INFORMIMIT**Domeniko SINJARI**